



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES




28 KORRIK - **3** GUSHT
JAVA E MBROJTJES

QEVERIA, PAKETË MBËSHTETËSE PËR TË PREKURIT NGA ZJARRET

Qeveria do të ofrojë një paketë mbështetëse për banorët e zonave të prekura nga zjarret, për të kompensuar dëmet e shkaktuara në banesa, bujqësi apo blegtori. Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, gjatë një takimi koordinues, ku të pranishëm ishin edhe ministri i Brendshëm Ervin Hoxha, ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Anila Denaj dhe drejtori i Përgjithshëm i AKMC Haki Çako, tha se në qendër të diskutimeve ishin: vlerësimi i gatishmërisë operationale për Emergjencat Civile dhe vlerësimi i dëmeve dhe përgjigjes që duhet të marrin banorët e prekur.

★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES


ZJARRET, FA NË TERREN

Gjatë kësaj jave, rreth 1300 trupa, 5 helikopterë dhe disa mjete zjarrfikëse janë angazhuar në terren për shuarjen e vatrave të zjarrit në disa zona të vendit. Janë kryer mbi 60 aksione nga ajri, ndërsa falë ndërhyrjes së shpejtë dhe të koordinuar, shumica e vatrave janë neutralizuar. Strukturat mbeten në gatishmëri për çdo situatë emergjente.

JM

★★★★★

mod.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES




RINGRITJA E KANTIERIT DETAR PËR PRODHIMIN E ANIJEVE TË FD

Në Bazën Detare të Pashalimanit ka nisur vlerësimi teknik me partnerët italianë për ringritjen e kantierit detar të prodhimit dhe mirëmbajtjes së anijeve të Forcës Detare. Në 9 muajt e fundit, 20 kompani kanë shprehur interes për bashkëpunim me shoqërinë shtetërore KAYO, dhe pas negociatave të finalizuara në qershor-korrik 2025, po ngrihen tre sipërmarrje të reja për prodhimin e mjeteve të blinduara, uniformave dhe municioneve, ndërsa vijojnë bisedimet për armatim të lehtë, artileri dhe dronë luftarakë.

★★★★★

mod.gov.al

JM



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES

DIPLOMOHEN 90 OFICERË DHE KADETË TË RINJ

90 studentë/kadetë, që përfunduan Akademinë e FA (AFA), do t'i bashkohen trupës së oficerëve të Forcave të Armatosura. Mes oficerëve të rinj, që bënë betimin ushtarak para Flamurit Kombëtar, ishin edhe pesë studentë nga Kosova. Në ceremoninë e diplomimit, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, e cilësoi këtë si një moment të rëndësishëm, jo vetëm për ata personalisht, por për të gjithë institucionin ushtarak dhe shtetin shqiptar.

★★★★★

mod.gov.al

JM



FORCAT SHQIPTARE NË PARADËN E FITORES NË ZAGREB

Me rastin e 30-vjetorit të Ditës së Fitores dhe të veteranëve në Kroaci, Shqipëria ishte e ftuar nderi në paradën ushtarake të mbajtur në Zagreb. Me ftesë të homologut kroat, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralejtënant, Arben Kingji, mori pjesë në aktivitet, ku flamurtarët shqiptarë marshuan krah për krah me forcat kroate dhe aleate, në shenjë partneriteti dhe miqësie mes dy vendeve.

★★★★★



FORCOHEN KAPACITETET KIBERNETIKE TË FA

Në Komandën Kibernetike dhe Ndërlidhjes u zhvillua ceremonia e çertifikimit të Kursit Bazë dhe të Avancuar për nënoficerët në specialitetet e kibernetikës, ndërlidhjes dhe radiozbulimit. Personeli i trajnuar u pajis me njohuri të avancuara për teknologjitë moderne, duke forcuar kapacitetet operacionale të sigurisë dhe sistemeve të informacionit në FA.

★★★★★

7 KUOTA STUDIMI PËR TË RINJTË NË GREQI

Qendra e Personel Rekrutimit fton të gjithë të rinjtë ambiciozë të aplikojnë për 7 kuota studimi në shkollat e larta ushtarake në Greqi. Programet përfshijnë Forcat Tokësore, Detare dhe Shërbimet e Forcave të Armatosura në fusha si mjekësia, psikologjia, ekonomia dhe drejtësia. Afati për dorëzimin e dokumentacionit është 8 gusht 2025 pranë QPR.

